



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje
Department for Education



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje

RAPORTI 3 MUJOR I PUNËS

-IV- Nr. i prot. 04/706 Më Dt. 07.04.2021 Janar – Mars, 2021
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Drejtoria për Arsim në 3 mujorin e parë të vitit 2021 ka punuar dhe është munduar t'i realizojë planifikimet e bëra të planit vjetor të punës, përkatësisht sipas planifikimeve të aktiviteteve të parapara gjatë këtyre 3 muajve. Aktivitetet dhe punët e kryera gjatë kësaj periudhe po i paraqesim të përmbledhura sipas muajve, siç vijon:

Në fillim të muajit janar, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës kemi dërguar kërkesat për furnizim me inventar për objektet e reja shkollore që janë në ndërtim e sipër. Jemi furnizuar me pako higjienike përmes Ministrisë së Arsimit dhe organizatës UNICEF dhe poashtu jemi furnizuar me 15 tabletë për fëmijët me nevoja të veçanta. Punët kanë rifilluar në projektin e riparimit të shkollave (Lot1), përkatësisht në riparimin e dyshemeve në shkollën "Rudolf Walther" të Dejnit dhe ndërrimin e dyerve të klasave në shkollën "Katër Dëshmorët" në Ratkoc dhe në objektin e shkollës "Hamëz Thaçi" në Xërxë.

Kemi bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e mësimin në gjysmëvjetorin e dytë, kemi bërë pastrimin dhe dezinfektimin e shkollave dhe kemi planifikuar që Pakoja Pedagogjike për klasat 0 deri 5, të shpërndahet në të gjitha shkollat. Punët kanë vazhduar në projektin e riparimit të shkollave, përkatësisht në objektin e shkollës "Hamëz Thaçi" në Xërxë. Kemi mbajtur një takim në Kolegjiumin për Arsim në Prishtinë, në të cilin kemi hartuar planin e punës së kolegjiumit për vitin 2021. Kemi bërë vizita në disa shkolla për të parë nga afër ecurinë e fillimit të mësimin në gjysmëvjetorin e dytë dhe kemi shpërndarë Paket Pedagogjike për klasat 0 deri 5 në të gjitha shkollat.

Në muajin shkurt është mbajtur një takim me drejtorët e shkollave dhe me përfaqësuesit e Këshillit të Prindërve të secilës shkollë, ku të pranishëm kanë qenë edhe pjesëtarët e stacionit policor në Rahovec. Në këtë takim kemi biseduar për sigurinë në shkolla dhe përgatitjet për fillimin e mbajtjes së garave shkollore të olimpiadës së matematikës dhe fizikës.

Nëpër shkolla ka filluar mbajtja e garave shkollore me nxënësit e klasave të 9, 10, 11, 12 të olimpiadës së matematikës dhe fizikës, të cilët pastaj do të jenë pjesë e garave komunale. Mbajtëm një punëtori me Caritasin e Zvicrës për zbatimin e projektit të pajisjes me inventar të klasave parafillore.

Nëpër shkolla ka përfunduar mbajtja e garava shkollore me nxënësit e klasave të 9, 10, 11, 12 të olimpiadës së matematikës dhe fizikës, të cilët pastaj morën pjesë në garat komunale. U mbajtën Garat komunale të Olimpiadës së Matematikës, e poashtu edhe Garat Komunale e Fizikanëve të Rinjë. Procesi i garave shkoi mire dhe të njëjtën ditë i angazhuam komisionet vlerësuese për të vlerësuar punimet e nxënësve dhe për nxjerrjen e rezultateve në nivel komune.

Punët kanë vazhduar në projektin e riparimit të shkollave (Lot1), në fasadimin e jashtëm të objektit të ri të shkollës “Haki Stërmilli” në Retijë dhe punimet në objektin e ri të shkollës “ Herojntë e Kosovës” në Hoçë të Vogël-Brestoc.

Në muajin mars, punët kanë vazhduar në projektin e riparimit të shkollave (Lot1) në Guri të Kuq, Çifllak dhe në Drenoc, kanë vazhduar punimet në ndërtimin e çerdhes në Xërxë, ku u bë instalimi i rrjetit të rrymës elektrike e po ashtu edhe në çerdhen në Ratkoc. Punimet kanë vazhduar edhe në ndërtimin e shkollës në Retijë dhe Kaznik e poashtu edhe në Fortesë. Kemi nisur procedurën për realizimin e projektit “Furnizimi i bibliotekave të shkollave me libra” dhe procedurën e projektit “Instalimi i kamerave në shkollat e komunës së Rahovecit.

Për nder të festës së 7 Marsit nderuam me mirënjohje të pensionuarit e vitit të fundit, veteranët e arsimit që kanë mbi 70 vjetë dhe familjarët e mësimdhënësve të ndjerë që humbën jetën gjatë periudhës së pandemisë. Në Ministrinë e Arsimit kemi dërguar specifikacionet për pajisjen me inventarë të 3 çerdheve të reja.

Edhe gjatë këtij muaji, punët kanë vazhduar në projektet e riparimit të shkollave (Lot1 dhe Lot2) në Çifllak ku u punua në ndërtimin e aneksit të nyjeve sanitare të shkollës, në Drenoc ku ka përfunduar montimi i dyerve të klasave dhe do të vazhdohet me punët e dysHEMEVE të klasave.

